



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1751 prot

Korçë, më 18/10/2019

VENDIM

Nr. 557, datë 18.10.2019

PËR

**RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PROGRAMEVE TË CIKLIT TË PARË  
DHE CIKLIT TË DYTË NË UNIVERSITETIN "FAN S. NOLI"**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të", pika 2.7 gërma b) "Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, kapaciteti i kuotave të programeve mund të përshtatet nga IAL-të në përputhje me interesin e studentëve, për programet e të njëjtit cikël studimi, që ofrohen nga njësitë bazë të së njëjtës njësi kryesore, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore", Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.10.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë rishpërndarjen e kuotave në programin e studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte" në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë duke shtuar 16 kuota, nga kuotat e programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Fillor" në të njëjtin fakultet.
2. Të miratojë rishpërndarjen e kuotave në programet e ciklit të dytë "Master Profesional" si më poshtë:
  - "Master Profesional" në "Mësues për Arsimin Fillor", në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë shtohen 10 kuota, nga këto 5 kuota nga "Master Profesional" në "Mësues në Gjuhën Shqipe dhe Letërsi" dhe 5 kuota nga programi i studimit "Master Profesional" në "Mësues i Gjuhës Angleze" (4 nga shqiptarë brenda vendit dhe 1 nga trojet) në të njëjtin fakultet.
  - "Master Profesional" në "Mësuesi në Histori dhe Gjeografi", në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë shtohet 1 kuotë nga kuotat e veçanta të këtij programi studimi.
  - "Master Profesional" në "Mësues në Matematikë dhe Informatikë-Fizikë", në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane shtohen 2 kuota nga kuotat e programeve të studimit "Master Profesional" në "Administrim Publik" (1

kuotë nga trojet) dhe “Master Profesional” në “Mësues në Shkencat Sociale”  
(1 kuotë nga trojet) në të njëjtin fakultet.  
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

\*Bashkëlidhur tabela e kuotave të pranimit për vitin akademik 2019-2020 për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë me ndryshimet e lartpërmendura.

**KRYETARI I SENATIT**  
**REKTORI**  
**Prof. dr. Ali Jashari**

